**AKT THEMELIMI I SHOQERISE**
**Trogen sh.p.k.**
(shoqeri me ortak te vetem)

Sot, me date 10/02/2022, ne Tirane, nenshkruhet ky akt themelimi nga ortaku i vetem i shoqerise Trogen Sh.p.k. si vijon:

**Milot Gjikolli**, shtetas kosovar, lindur me 07.04.1970, ne Peje, me adrese banimi ne Lagjia "Marigona", Rruga "Hawai", Prishtine, Kosove, me pasaporte nr. P00761276 ("**Ortaku Themelues**", ose "**Ortaku**").

## I. Themelimi

Ortaku Themelues deklaron themelimin e shoqerise **Trogen sh.p.k.**, nje shoqeri shqiptare me pergjegjesi te kufizuar ("**Shoqeria**"), e cila themelohet ne perputhje me ligjin e zbatueshem tregtar ne Republiken e Shqiperise.

Selia e Shoqerise eshte ne adresen: *Bulevardi Deshmoret e Kombit, Twin Towers, Nr. 24, 1019, Tirane, Shqiperi.*

## II. Kohezgjatja

Shoqeria eshte themeluar per nje kohezgjatje te pakufizuar.

## III. Objekti

Objekti i aktivitetit te Shoqerise, do te perfshije, por nuk kufizohet ne aktivitetet e meposhtme:

(i) Aktiviteti kryesor i Shoqerise do te jete prodhimi dhe gjenerimi i energjise elektrike nga burime te te gjitha llojeve, me fokus te vecante ne energjine e rinovueshme, perfshire burimet hidrike, te diellit dhe eres, dhe jo vetem, aktivitete te tregtimit dhe furnizimit te saj, me fokus te vecante ne energjine e rinovueshme, por jo vetem.
(ii) Aktivitetet e eksportit dhe importit ne teresi per te gjitha mallrat dhe sherbimet.
(iii) Aktivitete te inxhinierise, konstruksionit, dizajnit, zhvillimit, operimit dhe manaxhimit te objekteve te prodhimit, furnizimit, tregtimit te energjise elektrike; si dhe
(iv) Cdo aktivitet tjeter (perfshire te gjitha mallrat, produktet dhe sherbimet) cili lejohet nga ligjet ne Republiken e Shqiperise

Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, ne menyre qe te arrihet qellimi i siperpermendur, Shoqeria mund:



MG

(i) te kryeje çdo aktivitet me pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme (perfshire por pa u kufizuar ne blerjen, shitjen, e marrjen dhe dhenien me qera te sendeve te luajtshme dhe te paluajtshme) si edhe aktivitete tregtare, financiare, qira apo hipotekore te cilat mund te konsiderohen te dobishme apo te nevojshme per permbushjen e objektit te Shoqerise dhe qe nuk tejkalojne ne mase aktivitetet kryesore, te cituara me siper;
(ii) te bleje, ne menyre te drejtperdrejte apo te terthorte, interesa ne shoqeri te tjera qe kane objekt (objekti i aktiviteti) te ngjashem me ate te Shoqerise, ne Shqiperi apo jashte saj;
(iii) te kryeje çdo aktivitet tjeter qe mund te konsiderohet i dobishem apo i nevojshem per permbushjen e objektit te Shoqerise.

Shoqeria kryen cdo lloj aktiviteti qe ben pjese ne objektin e saj, qe lidhet me te dhe qe e mbeshtet ate.

Shoqeria zbaton te gjitha ligjet dhe aktet nenligjore te duhura. Ajo zbaton standartet me te larta te etikes.

## IV. Statuti

Ortaku Themelues deklaron pajisjen e Shoqerise me statutin e Shoqerise, i cili firmoset ne menyre te rregullt nga Ortaku Themelues i Shoqerise njekohesisht me kete Akt Themelimi.

## V. Kapitali

Kapitali i regjistruar i Shoqerise eshte 100 Lek, i perbere nga 1 (nje) kuote dhe zoterohet nga Ortaku Themelues i Shoqerise, si vijon:

**Milot Gjikolli**, shtetas kosovar, lindur me 07.04.1970, ne Peje, me adrese banimi ne Lagjia "Marigona", Rruga "Hawai", Prishtine, Kosove, me pasaporte nr. P00761276.

## VI. Administratori

Shoqeria drejtohet nga 1 (nje) administrator, i cili eshte perfaqesuesi ligjor i saj dhe e perfaqeson ate ne marredhenie me te tretet dhe eshte pergjegjes per aktivitetin e zakonshem tregtar te Shoqerise, ne perputhje me statutin, ligjin shqiptar te zbatueshem dhe cdo vendim te Ortakut Themelues, ne cilesine ortakut te vetem te Shoqerise.

Administratori i pare Shoqerise emerohet Z. **Milot Gjikolli**, shtetas kosovar, lindur me 07.04.1970, ne Peje, me adrese banimi ne Lagjia "Marigona", Rruga "Haeai", Prishtine, Kosove, me pasaporte nr. P00761276.

Administratori emerohet per nje afat ne detyre prej 3 (tri) vitesh nga data e regjistrimit te Shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit ne Shqiperi ("**QKB**") me te drejte rizgjedhjeje.

 MG

*Ky Akt Themelimi u hartua ne 3 (tri) kopje te njejta.*

**ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE**

**Trogen Sh.p.k.**

**Milot Gjikolli**

_______________________